



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 430/03-27545/22
Kaçanik, 26.10.2022

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) 40.2 (g) lidhur me nenin 14 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008) të nenit 9 pika 1 paragrafët 1.1 deri 1.9 e Ligjit Nr. 06/L-005 -Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/15 Shkurt 2018), të nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 26 Tetor 2022, mori këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2023

1. Me këtë Vendim, caktohen normat tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- 1.1 Për njësiti bujqësore të parcelave----- (0.15%)
- 1.2 Për njësiti bujqësore të objekteve----- (0.15%)
- 1.3 Për njësiti pyjore të parcelave----- (0.15%)
- 1.4 Për njësiti rezidenciale të parcelave----- (0.15%)
- 1.5 Për njësiti rezidenciale të objekteve----- (0.15%)
- 1.6 Për njësiti komerciale të parcelave----- (0.18%)
- 1.7 Për njësiti komerciale të objekteve----- (0.18%)
- 1.8 Për njësiti industriale të parcelave----- (0.18%)
- 1.9 Për njësiti industriale të objekteve----- (0.18%).

2. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës, do të fillojë me u zbatuar nga data 01 Janar 2023, ndërkajq do të jetë i zbatueshëm deri me 31 Dhjetor 2023.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Zyra e Tatimit në Pronë.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante); dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Nr. i Org. 02/MAV Nr. Prot. 2625-1/2022
Org. Jedin. Org. Unit
Nr. i fletëve 8 Data 14.11.2022
Broj stranica No. pages: 8
Data 14.11.2022



HYRESE - ULAZNA - INCOMING
KOSOVA KRAJINISKA PRILAZNA - KOSOVA KRAJINISKA PRILAZNA
GENERAL KOSOVËS - VLAZNA - GENERAL KOSOVËS
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartvo Lokalne Samostavne Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data 14.11.2022
Datum
Date
Nivelo organizativ Niv. i Lendës Vlera
- VI. 020-962/6



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK

I	Data 14.11.22	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	430/03-30631	Republika Kosova - Republic of Kosovo

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë: 276/2022
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Bora Duli, Zyrtare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Vehap Hashani, Zyrtare i Lartë Ligjor, Departamenti për Tatim në Pronë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Ilazi,
I nderuari Kryesues z. Murseli,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimi 01Nr. 430/03-2754/22, për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023
<i>I miratuar më datë 26.10.2022</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 28.10.2022</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 31.10.2022</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), duke u bazuar vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë, si dhe pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Kaçanikut, jep konstatimet ligjore bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

1. Komuna e Kaçanikut, me anë të aktit që është subjekt i shqyrtimit, synon caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.
2. Si pikë e parë, dhe për qëllime të këtij vlerësimi është me rëndësi të theksohet se neni 9 i Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal i autorizon Komunitat që të mbledhin tatimin në pronat e paluajtshme, të cilat ndodhen brenda kufijve territoriale të saj.
3. Për të konkretizuar konstatimin e mësipërm, si dhe tregues i rëndësishëm për të vlerësuar caktimin e normave tatimore për kategoritë e pronave nga Komunitat mbetet Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (këtej e tutje referuar si “Ligji”); ku ndër tjerash, precizohen edhe konditat ligjore për caktimin e rregullt të normave tatimore.
4. Relevante për rastin konkret është paragrafi 1 i nenit 9 të Ligjit, ku precizohet qartë se:

“Kuvendi komunal i çdo komune cakton normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, deri më 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit në përputhje me këtë Ligj.”

5. Nëse elaborohet vlerësimi ligjor krahas frymës së paragrafit 1 të nenit 9 të Ligjit dhe përmbajtjes së aktit administrativ komunal, mund të evidentohet se Kuvendi komunal i ka caktuar normat tatimore për kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike, para afatit kohor të 30 nëntorit. Duke qenë kështu, Komuna ka vepruar në konformitet me konditat ligjore të përcaktuara në këtë paragraf.

6. Rrjedhimisht, dhe si përfundim i këtij vlerësimi, akti administrativ i Komunës së Kaçanikut është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!